**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 04/2 prot Datë 04.01.2024

# FORMULAR PËR PUBLIKIM LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT NGRIHEN PRETENDIME

| | |
|---|---|
| **Objekt**: | Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë "Bregu Company" SHPK dhe "Ervin Luzi" PF në procedurën e prokurimit *"Procedurë e hapur, e thjeshtuar*", me Nr. REF-89767-12-05-2023, me objekt: "*Blerje materiale sanitare (detergjentë, pastrues e.t.j.)"*, me fond limit 1,771,785 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 18.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA. |
| **Ankimues:** | Operatori ekonomik "Marketing & Distribution" SHPK, me NIPT (J72124001N), me adresë: Autostrada Tiranë – Durrës, Km.10, Kashar, Rruga "Iliria", Nr.53, Tiranë |
| **Autoriteti Kontraktor:** | Albpetrol SHA, me adresë: Rruga Fier – Patos, Km 7 |
| **Subjekte të Interesuara:** | Operatori ekonomik "Bregu Company" SHPK, me NIPT (L82729403H), me adresë: Zharëz, Frashër, Fshati Frashër, Godina 1 katëshe, Zona Kadastrale nr. 1638, Nr. Pasurie 57/7, Patos, Fier<br><br>Operatori ekonomik "Ervin Luzi" PF, me NIPT (K71707007Q), me adresë: Lagja "Katund i Ri", Rruga "Ali Pashë Gucia", Godina Nr.5, Yrshek, Kashar, Tiranë |

Në datën 03.01.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. protokolli 04 datë 03.01.2024 e operatorit ekonomik "Marketing & Distribution" SHPK për procedurën e prokurimit *"Procedurë e hapur, e thjeshtuar*", me Nr. REF-89767-12-05-2023, me objekt: "*Blerje materiale sanitare (detergjentë, pastrues e.t.j.)"*, me fond limit 1,771,785 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 18.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë "Bregu Company" SHPK dhe "Ervin Luzi" PF.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma "c" të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", ku parashikohet se: "*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar****; c) pretendimet mbi kualifikimin/ skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime****."*

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik "Marketing & Distribution" SHPK me anë të ankesës me nr. protokolli 04/2023 datë 03.01.2024, pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë "Bregu Company" SHPK dhe "Ervin Luzi" PF, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht, në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorëve ekonomikë "Bregu Company" SHPK dhe "Ervin Luzi" PF, të kritereve si më poshtë:
*[...]*

*2.3.2. Operatori ekonomik duhet te paraqesë perpara afatit të fundit për hapjen e ofertave nga një mostër përfaqësuese një copë për artikujt me numër rendor 7, 10, 14, 21, 28 sipas tabelës së sasive.*

*Mostrat te paraqiten dhe te dorezohen ne zyren e protokoll arkives te Albpetrol sha Patos me seli ne rrugen Fier-Patos km 7, se bashku me nje dokument per paraqitje mostre te protokolluar ne Albpetrol sha, perpara afatit te fundit per paraqitjen e ofertave, ne menyre qe te jene ne dispozicion te Komisionit te Vleresimit te Ofertave.*
**Mostrat do te jene kofidenciale per secilin Operator Ekonomik dhe do ti kthehen Operatorit ekonomik brenda 30 diteve nga data e lidhjes se kontrates me paraqitjen e nje kerkese prane AK nga ana e OE ofertues.*

*2.3.3. Operatori ekonomik duhet te paraqes autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për artikujt me numër rendor 7, 10, 14, 21, 28 sipas tabelës së sasive. Ne rastin e*

*distributorit te autorizuar te paraqitet edhe dokumenti qe verteton lidhjen e distributorit te autorizuar me firmen prodhuese. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: tel, fax, email, ëebsite, kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi nga ana e tij.*

*2.3.4. Operatori ekonomik duhet te paraqese katalog/skede teknike nga prodhuesi, per artikujt me numër rendor 7, 10, 14, 21, 28 sipas tabelës së sasive.*
*Katalogu/Skeda teknike te permbaje karakteristikat teknike te artikujve që janë objekt i prokurimit me qellim që Autoriteti Kontraktor të gjykoje nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në katalogun/skedën teknike të paraqitur të shenjohen në mënyrë të dukshme të gjitha specifikimet teknike të mallit të ofruar. (Pjesët specifike të katalogut/skedës teknike ku jepen karakteristikat e mallit që ofertohet nqs nuk janë në gjuhën shqipe të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen).*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 04.01.2024.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**
**Jonaid Myzyri**

Digitally signed by
Jonaid MYZYRI
Date: 2024.01.04
04:53:31